



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 823/10 Prot.

Tiranë, më 21.04 2026

VENDIM

Nr. 65 dt. 21.04 2026

**“PËR
MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOSJES SË KANDIDATIT DR. BLERINA ALIAJ
PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR” PRANË KPPA-SË”**

Në zbatim të nenit 38, 61, 79 pika 7 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreut IV pika 1 dhe 2 të Vendimit nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20, 27 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 24 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, mbështetur në shkresën Nr. 468/10 Prot., datë 15.04.2026 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes “Përcjellje e dokumentacionit për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar” të Dr.Blerina Aliaj”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.04.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë përcjelljen e dosjes së kandidatit Dr. Blerina Aliaj për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Njësisë Kryesore FVFR-së si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Dixhitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Agron KASA

